

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë në çështjen juridike të paditësit N.P.SH "[A...]" me seli në Fushë Kosovë, i përfaqësuar me autorizim nga avokat, "[D.S]" nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "[E...]" me seli në Prishtinë, te cilën e përfaqëson me autorizim "[MB]", për shkak të kompensimit të dëmit në shumën e përgjithshme prej 2,377.38€, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.205/2016 të datës 20.09.2 017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.02.2019, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditurës Kompania e Sigurimeve "[E...]" me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.205/2016 të datës 200 9.2 017 , **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.P.SH "[A...]" me seli në Fushë Kosovë, ku në pikën I. Të dispozitivit është detyruar pala e paditur Kompania e Sigurimeve "[E...]" me seli në Prishtinë, që paditësit N.P.SH "[A...]" me seli në Fushë Kosovë, t'ia paguaj borxhin në emër të kompensimit të dëmit shumën e përgjithshme prej 2,377.38€, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8 % e cila do të llogaritet nga data 08.04.2016, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin parativ prej 7 ditësh, duke llogaritur nga data e pranimi të këtij aktgjykimi. Ndërsa në pikën II. të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t'ia kompensoje shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 437.0 0€ në afatin kohor prej 7 ditësh nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktik dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i kërkuar Gjykatës Apelit në Prishtinë që ta aprovon ankesën si të bazuar, aktgjykimin me numër, III.EK.nr.205/2016 të datës 20.09.2 017 ta prishë, ashtu që rastin ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK, gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar.**

Paditësi N.P.SH "[A...]" me seli në Fushë Kosovë, me datë 12.04.2016, ka parashtruar padi lidhur më kompensim dëmit të pësuar nga aksidenti i komunikacionit me datën 27.12.2014, për çka edhe ka kërkuar nga gjykata t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 3,152.38€, me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga data 08.04.2016, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "[E...]" me seli në Prishtinë. Paditësi pas marrjes se mendimit dhe konstatimit të ekspertit të komunikacionit të datës 28.07.2017 ka bërë precizimin e kërkesëpadiës në shumën prej 2,377.38€.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së e paditura nuk e ka kontestuar bazën juridike ë kërkesëpadiësë, respektivisht ka pranuar përgjegjësinë lidhur me shkaktimin e dëmit, andaj gjykata nuk është lëshuar në shqyrtimin e provave të cilat i referohen rrethanave, vendit dhe pjesëmarrjes në aksident si dhe përgjegjësinë për kompensimin e dëmit. Prandaj gjykata e shkallës së parë me propozimin e palës paditëse ka nxjerre provën më anë të ekspertizës së makinerisë nga eksperti gjyqësorë "[B.L]", i cili ne ekspertizën e datës 28.07.2017 ka dhënë mendimim dhe konstatimin se automjeti i markës Mitsubishi Pajero me targa [...], ka pësuar dëmtime të shkaktuara në pjesën e përparme të djathtë dhe se vlera e përgjithshme e dëmit të shkaktuar arrin shumën ë përgjithshme 2,377.38€.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave dhe nxjerrjes së ekspertizave përkatëse, bazuar në dispozitat e Nenit 136 par 1 dhe të LMD-së, e ka aprovuar kërkesëpadiinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të akgjymimit të atakuar. Për përcaktimin e lartësisë së dëmit të shkaktuar gjykata ka mbështetur konstatimin e ekspertit duke e marre për bazë rregulloren mbi trajtimin e dëmeve që rrjedhin nga sigurimi i detyrueshëm nga auto përgjegjësia, procesverbali për riparimin e automjetit, fotografitë e automjetit të dëmtuar dhe raportit policor i aksidentit. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se shkaktar i aksidentit ka qene i siguruari i të paditurës dhe e autorizuara e të paditurës nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadiësë, andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat dhe mbi gjendjen faktike ka gjetur se kërkesëpadiia e paditësit është e bazuar. Prandaj, gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadiinë e paditësit duke u bazuar në dispozitat e Nenit 136.1, dhe 382.2 të LMD-së, lidhur me Nenin 143 të LPK-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullit dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe

ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet ankimore të së paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë përmes ekspertizës profesionale të mjaftueshme, e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse në arsyetimin e aktgjykimit, të cilën e pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të së paditurës lidhur me lartësinë e shumës së kompensimit të aprovuar nga gjykata e shkallës së parë por gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka përcaktuar lartësinë e kompensimit duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e këndës dhe në ekspëertizën e makinerisë nga eksperti gjyqësorë [B.L].

Bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,**  
**Ae.nr.259/2017, 22.02.2019**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
**Mahir Tutuli, d.v.**  
